

## Raport mbi punën e Komisionit për ankesa gjatë vitit 2016

Komisioni për ankesa pranë Këshillit për Etikë në Media në Maqedoni, gjatë periudhës së kaluar punoi në kushte të diktuar nga situata në sferën e mediave në Maqedoni.

Mu kjo bëri që Komisioni të takohet më shumë se një herë në javë, siç është e paraparë me Rregulloren për punën e tij. Gjithçka varej nga vëllimi i ankesave të pranuar dhe koha në të cilën vinin ato. Vendimet e Komisionit, më së shpeshi merreshin me konsensus. Në parastresë, ku kishte përplasje interesash të anëtarëve të Komisionit, ata largoheshin nga pjesëmarrja. Komisioni përpigëj që gjithmonë të punojë në përbërje të plotë, madje edhe duke përdorur skajp-lidhje për komunikim.

Mund të konstatohet se në periudhën e kaluar është rritur numri i ankesave të pranuar. Gjithsesi, kjo nuk është tregues për punën e Këshillit për etikë. Mund të ndodh të pranohen edhe me mijëra ankesa. Ky numër do të tregojë se Këshilli është i dukshëm, por, gjithashtu tregon se profesionalizmi dhe etika janë të kundërta proporcionale me numrin e ankesave. Konstatim i përgjithshëm i Komisionit është se gjendja me etikën në media tek ne po përkeqësohet.

Disa fjalë rreth asaj që tregoi puna e deritanishme. Së pari, gazetarët sikur kanë harruar atë që i mësojnë gjatë ditëve të para të studimeve për gazetari. Se informacionet duhet të jenë të sakta dhe të besueshme. Ndoshta, në mbi 80 përqind të parastresave është konstatuar se është harruar leksioni nga fakulteti apo nga redaksia. E dyta, fokusi është në interesin privat duke mos iu trembur syri gazetarit për pasojat e një sjelljeje të tillë. Më tutje, sikur harrojnë se gjuha e urrejtjes është një vepër penale, si dhe diskriminimi në baza të ndryshme. Gjithashtu, gazetarët më shumë preferojnë të komentojnë se sa të raportojnë dhe të punojnë me fakte. Fakti, sikur po shndërrohet në një kategori të fshirë. Nuk ka kultivim të kulturës së të folurit dhe nuk zhduket komunikimi i papërshtatshëm me opinionin.

Harrohet se edhe raportimi gjatë zgjedhjeve duhet të jetë i paanshëm dhe i balancuar. Ju përkujtojmë se KEMM-i këtë pranverë përgatiti një Kartë për raportim të drejtë dhe të balancuar mbi zgjedhjet në vend, atë e nënshkruan pothuajse nëntëdhjetë media, por,

akoma pa u tharë ngjyra e lapsit e nënshkrimit, mediat sikur harruan se çfarë kishin nënshkruar.

Tani pak statistikë. Pasi që ka kohë që nuk jemi parë, fillimisht, disa numra për periudhën që nga formimi i Komisionit, gjegjësisht, fillimi i punës së saj praktike. Që nga fillimi i vitit 2015 e deri më tani, deri te Komision kanë arritur 179 ankesa. Komisioni ka marrë 149 vendime në të cilat është konstatuar shkelje e Kodeksit të gazetarëve në Maqedoni. Gjashtë raste janë zgjidhur me anë të ndërmjetësimit. 13 ankesa janë refuzuar pasi që ishin të vonuara ose nuk ishin fare nën kompetencat e Komisionit. Një ankesë është tërhequr, ndërsa dy të tjera janë mbyllur pasi që kishin skaduar afatet procedurale dhe nuk kishte asnjë përgjigje nga ankuesi.

Për lehtësimin e qasjes deri te vendimet e Komisionit për ankesa dhe rritjen e dukshmërisë praktike të vendimeve të saj, Zyra Ekzekutive në vitin e kaluar bëri përpjekje dhe tani vendimet i kemi në një vend dhe me mundësi shfletimi, si për nga numri i vendimeve ashtu edhe për nga shkeljet e ndonjë neni konkret, emrat e ankuesve dhe të mediave. Ky shqyrtim mund të gjendet në faqen e KEMM-it, adresa është <http://www.semm.mk/attachments/pregled-na-odluki-2016.pdf>. Nga këtu mund të shihni se vjet janë marrë 76 vendime për shkelje të standardeve etike e profesionale. Përndryshe, Komisioni për ankesa në vitin 2016 mori gjithsej 85 vendime në bazë të ankesave të pranuar, nga të cilat për 9 prej tyre ishte vendosur se janë të pabaza, ndërsa tek të tjerat është përcaktuar shkelje e Kodeksit të gazetarëve. Kështu, të themi se përveç ata që i përmendëm më parë, dy ankesa janë zgjidhur me ndërmejtësim, ndërsa 10 janë refuzuar, pasi ishin jashtë kompetencave të KEMM-it apo të vonuara. Për një rast prodceura u mbyll në bazë të afateve të skaduara procedurale.

Në 76 vendimet e përmendura, ku është konstatuar shkelje e profesionalizmit dhe e etikës, neni më i shkelur me 66 raste të shkeljeve apo 86,8% të vendimeve është neni 1 nga Kodeksi, i cili ka të bëjë me publikimin e informatave të sakta dhe të vërtetuara, sigurimi i „palës së dytë“ dhe sa më shumë të jetë e mundur, ose së paku dy burime të pavarura. Neni 13. - Gazetari duhet të bëjë dallimin mes fakteve dhe opinionëve, mes lajmit dhe komentit, është shkelur në 54 raste, me 71,1 % të ankesve. Neni 14, sipas të

cilit raportimi mbi proceset politike, sidomos mbi zgjedhjet, duhet të jetë i paanshëm dhe i balancuar dhe me një distancë profesionale nga subjektet politike, janë vërejtur 26 shkelje me 34,2 %. Neni 4. - Gazetari do ta emërtojë burimin e informacionit, por, nëse burimi kërkon që të mbetet anonim, gazetari do ta mbrojë atë, ky nen është shkelur 23 herë. Neni 10.-,sipas të cilit gazetari nuk do të krijojë me vetëdije informacione, të cilat i cenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë apo diskriminim mbi çfarëdo baze, është shkelur 17 herë, me 22,4 %. Neni 16, në të cilin thuhet se gazetari do ta ruajë prestigjin dhe dinjitetin e profesionit të tij, do ta nxisë solidaritetin reciprok dhe nuk do ta përdorë median e tij për qërim hesapësh me persona, përfshirë këtu edhe kolegët e tij, është shkelur 14 herë. Neni 7, i cili ka të bëjë me respektimin e privatësisë së personit, përveç kur kjo është në kundërshtim me interesin publik. Dhe, se gazetari është i detyruar ta respektojë dhimbjen dhe zinë personale është shkelur 15 herë. Nën dhjetë shkelje janë hasur në nenin 11- Gazetari do t'u përmbahet standardeve shoqërore gjithëpërfshirëse të mirësjelljes dhe respektimit të diversitetit etnik, kulturor dhe religjioz në Maqedoni, neni 15 i cili flet për etikën e të folurit, pastaj neni 3 në të cilin thuhet se gazetari do të tentojë që të sigurohet publikimi i korigjimit, demantit dhe përgjigjes në raste kur vërtetohet josaktësi në informacion, neni 8 i cili flet për sensacionalizmin, dhe neni 9 i cili ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të fëmijës.

Bazuar në atë se për çfarë medime janë dorëzuar ankesat, portalet janë liderë. Më pas vijnë televizionet nacionale dhe në fund gazetatat. Kjo është normale, pasi që portalet janë ndër mediat më të shumta. Të gjithë e shohim se çfarë bëhet në sferën onlajn. Shpiken tema, lajme, ngjarje, madje kemi edhe publikim kolektiv të një teksti të njëjtë, pa mos u ndryshuar asnjë pikë, dhe presje. Ka tekste përplot me gënjeshtër të dukshme, pasi që ata nuk janë të mbështetura me fakte. Tekste, në të cilat thuhet „mësojmë“,dhe nuk thuhet „jemi në dijeni“. Gazetarët duhet të zbulojnë, por, jo vetëm nga një burim ose nga ndonjë qendër për marrëdhënie me publikun. Kemi ankesa kundër mediave të cilave nuk mund t'ua gjejmë as adresën për komunikim, dhe, as që kanë impresum e as redaksi.

Si është raporti i mediave ndaj vendimeve të Komisionit. Neve na gëzon që shumica e mediave tani më kanë publikuar vendimet tona, edhe pse disa prej tyre nuk janë

themeluesit tanë, dhe nuk ishin në favor të tyre. Për shembull, javorja FOKUS, Televizioni 24 orë, Televizioni Nova dhe të tjerë. Supozojmë se kjo do të jetë volant dhe për mediat e tjera, veçanërisht për themeluesit e KEMM-it, që të sillen në të njëjtën mënyrë, pasi që kjo është esenca e ekzistimit të Këshillit për etikë. Nëse veç më janë përcaktuar të jenë pjesë e një trupi etik vetërregullues, atëherë duhet t'i respektojnë veprimet e tij. Në anën tjetër, nuk na gëzon fakti kur në përgjigjet e tyre ndaj ankesave, një pjesë e kryeredaktorëve na thërrasin „sorosoidë“ ose janë vulgarë dhe kërcënojnë.

Në periudhën e kaluar, para Komisionit nuk erdhi asnjë parashtresë e cila do tu referohej përmbajtjeve të huazuara, teksteve, videove dhe fotografive, edhe pse në biseda me kolegët kjo konsiderohet si dukuri e shpeshtë. Kodeksi i gazetarëve ka nene me të cilat mbrohet e drejta e autorit, si njëra nga çështjet ndaj të cilës duhet të sillen në mënyrë profesionale.

Në fund, do të shtoja se, nëse në të kaluarën kemi folur për rritjen e vizibilitetit të Komisionit dhe të Këshillit në mesin e popullatës, shoqërive civile, studentëve dhe kolegëve, tani kjo është një praktikë e rregullt. Vitin e kaluar, anëtarët e Komisionit dhe bordi drejtues disa herë vizituan institucionet e larta arsimore dhe përfaqësuesit e shoqërive civile. Në këto takime ishte prezantuar këshilli dhe puna e komisionit, dhe përshtypja është se takimet e tilla duhet të vazhdojnë, pasi që të rinjtë janë shumë të interesuar për punën që e bëjmë, ndërsa dijnë edhe çfarë të pyesin. Nuk është keq, kur të formohen kushtet, të vendoset praktika që Komisioni të mbajë takime edhe jashtë Shkupit, kuptohet, duke pasur parasysh mundësitë financiare për këtë. Mbledhjet e Komisionit edhe tani janë të hapura, ndërsa kështu do të ishin edhe ato jashtë Shkupit dhe në to do të mund të merrnin pjesë qytetarë, përfaqësues të sektorit civil, dhe të tjerë. Në këtë mënyrë, Komisioni dhe Këshilli, edhe më shumë do të afroreshin me publikun. Mendojmë se ky është një ndër qëllimet e KEMM-it.

Për fund, në botë tani po zhvillohet një fushatë për një lloj rregullimi apo mbikqyrje më e madhe e mediave onlajn. Kjo do të jetë një sfidë edhe për trupin vetërregullues. Dhe, kjo do të duhet të përshtatet me risitë, të paktën do të duhet ta harmonizojë Kodeksin ekzistues me kohërat e reja dhe kërkesat e reja.